



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 37, datë 20.12.2019

**Mbi miratimin e buxhetit të
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020**

Në mbështetje të nenit 44, pika 1, shkronja “a”, nenit 52, pika 1, shkronja “gj”, nenit 53, pika 5, shkronja “f” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 2, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe të Rregullores nr. 56, datë 29.09.2003 “Për hartimin e zbatimin e Buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin në Autoritet Mbikëqyrës të njoftimit për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020, si dhe një kopje të tij.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar